

**Republika e Kosovës—Deklaratë përmbyllëse nga vizita e stafit të FMN-së**  
Prishtinë, 16 shtator 2009

*Perspektiva afatshkurtër: Ngadalësimi i rregullt ka gjasë të pasohet nga një përmirësim vitin e ardhshëm*

**1. Midis shenjave që recesioni mbarëbotëror po shënon zbutje, ngadalësimi në rritjen ekonomike të Kosovës ka mbetur i rregullt.** Rritja e importeve, e remitencave dhe e depozitave ka vazhduar të ngadalësohet në muajt e fundit, duke treguar kështu për një ngadalësim të rritjes ekonomike. Megjithatë, këto forca janë kompensuar pjesërisht nga një rritje e shprehur në shpenzimet fiskale të këtij viti, veçmas për pagat dhe për shpenzimet kapitale. Veç kësaj, e shtytur nga importet, rënia në çmimet e konsumit ka vazhduar, me IÇK-në që ka rënë për rreth 4 për qind nga viti në vit në muajin korrik. Sido që të jetë, kërkesa për mallrat dhe shërbimet e prodhuara në vend duket të ketë qenë e përkrahur mirë. Kundrejt këtij sfondi, misioni e mban parashikimin e tij për rritjen reale të BVP-së për këtë vit dhe për vitin e ardhshëm kryesisht të pandryshuar (3.8 për qind, përkatësisht 4.3 për qind).

*Buxheti 2009: Presionet për shpenzime shkaktojnë shqetësime lidhur me qëndrueshmërinë*

**2. Presionet për shpenzime janë duke shkaktuar një përkeqësim të shprehur në deficitin fiskal themelor këtë vit.** Misioni vlerëson që shpenzimet publike do të rriten për 26 për qind këtë vit, me supozimin që ekzekutimi i shpenzimeve kapitale do të jetë nën alokimet buxhetore për këtë qëllim, ashtu si ka ndodhur në vitet e mëparshme. Të hyrat tatimore po shënojnë rritje kryesisht në linjë me parashikimet. Megjithatë, të hyrat jo-tatimore do të shënojnë shtytje nga pagesa e dividendit të parë dhe mjaft të lartë nga PTK (5 për qind e BPV), kompania publike e telekomunikacionit. Këto të hyra të njëhershme do të duhej të ndihmonin në mbajtjen e deficitit fiskal të këtij viti në rreth 2 për qind të BPV-së. Megjithatë, deficitin themelor—duke përjashtuar këto të ardhura nga dividendi—parashihet të arrijë në 7 për qind të BPV-së, duke theksuar kështu nevojën për veprime me politika, me qëllim të rikthimit të qëndrueshmërisë afatmesme të financave publike.

*Përgatitjet për buxhetin 2010: Masa shtesë nevojiten për të shtuar qëndrueshmërinë*

**3. Formulimi i politikave për buxhetin e vitit 2010 është në vazhdim e sipër, prandaj mbetet të kompletohet një vlerësim gjithëpërfshirës i pozicionit fiskal të qeverisë.** Përgatitjet për buxhetin janë ende në një fazë të hershme dhe misioni kryesisht pajtohet me parashikimet e autoriteteve sa i përket rritjes ekonomike dhe të hyrave. Drafti i tanishëm parasheh një deficit të vogël (0.3 për qind të BPV-së), duke pasqyruar pjesërisht reduktimin e shprehur në rritjen e shpenzimeve. Megjithatë, formulimi i politikave mbetet të finalizohet, prandaj një vlerësim gjithëpërfshirës i projektbuxhetit nuk është ende i mundur. Sidoqoftë, për të forcuar qëndrueshmërinë fiskale dhe kredibilitetin e buxhetit, misioni u rekomandon autoriteteve që të adresojnë çështjet e mëposhtme para finalizimit të qarkores së tretë buxhetore.

- *Huaja për sektorin e energjisë.* Projektbuxheti i tanishëm mbështetet në supozimin optimist që privatizimi i KEK, kompanisë publike energjetike, do të përmbillet vitin e ardhshëm. Në bazë kësaj pritjeje, projeksionet e autoriteteve për të hyrat përfshijnë kthimin e plotë të kredisë së KEK-ut nga pronari i ardhshëm që arrin në mbi 5 për qind të BPV-së (€197 milionë). Megjithatë, interesi në mesin e investuesve potencial për projektin “Kosova e re” duket se po pakësohet, dhe shtyrjet e mëtejme të privatizimit nuk mund të përjashtohen. Si një çështje e kujdesit, kthimi i huas nga KEK-u do të duhej larguar nga projeksionet e të hyrave për vitin 2010.
- *Subvencionet për sektorin e energjisë.* Vonesat e mundshme rreth privatizimit shkaktojnë gjithashtu rritjen e detyrimeve kontingjente të buxhetit nga operacionet e KEK-ut. Ndonëse projektbuxheti i tanishëm, përfshin subvencionet (1 për qind të BPV-së) për mbulim të kostos operacionale të kompanisë, kjo mund të jetë e pamjaftueshme. Marrë parasysh këto paqartësi, misioni rekomandon që në buxhet të lihet anash një rezervë kontingjente për sektorin e energjisë prej rreth 2 për qind të BPV-së.
- *Shpenzimet kapitale.* Projektbuxheti bazohet në një nivel ambicioz të shpenzimeve kapitale (10 për qind të BPV-së). Nëse merret parasysh performansa nga vitet e kaluara, shpenzimet ka pak mundësi të arrijnë në këtë nivel. Një veçim i qartë i alokimeve për planifikim të projekteve dhe ekzekutim, i kombinuar me analizën e dobisë së kostos për projektet e mëdha, do të mund të rezultonte në përmirësime materiale në planifikimin dhe efikasitetin e shpenzimeve. Për vitin 2010, kufiri i shpenzimeve kapitale do të duhej zbritur në linjë me shkallët e ekzekutimit që janë shënuar në vitet paraprake (rreth 85 për qind). Veç kësaj, misioni vlerëson instruksionet nga Ministria e Ekonomisë dhe Financës (MEF) për organizatat buxhetore, për të akomoduar bartjet eventuale të shpenzimeve kapitale në buxhetin e vitit të ardhshëm brenda kufijve të përcaktuar për vitin 2010, për të parandaluar një rritje të mëtejme të shpenzimeve.
- *Ligjet sociale dhe të ngjashme.* Efekti fiskal i disa prej iniciativave sociale që aktualisht janë në përgatitje e sipër mbetet të vlerësohet dhe do të mund të jetë i theksuar. Kostoja që lidhet me këto iniciativa duhet të përfshihet në projektbuxhetin 2010 apo këto iniciativa duhen hequr nga agjenda legjislative. Prandaj, misioni u bën thirrje autoriteteve që të vlerësojnë me saktësi koston fiskale nga këto iniciativa dhe që ti caktojnë prioritetet për shpenzimeve në përputhje me atë vlerësim.
- *Reforma në shërbimin civil.* Reformat e autoriteteve në shërbimin civil—të hartuara me përkrahje nga partnerët ndërkombëtarë—janë një hap me rëndësi drejt përmirësimit të funksionimit të sektorit publik. Megjithatë, vlerësimi më i fundit i efektit fiskal tregon që kostoja do të mund të jetë e konsiderueshme, dhe misioni u bën thirrje autoriteteve që ta kenë parasysh këtë koston gjatë finalizimit të projektligjit dhe gjatë ndërtimit të strukturës së re të pagave dhe gradimeve. Cilado rritje potenciale në faturën e pagave që rezulton nga këto reforma duhet kompensuar, përfshirë këtu krijimin e madhësisë së duhur në nivelet e stafit. Nëse këto reforma vërtetë bëhen efektive vitin e ardhshëm, cilado kosto që lidhet me to duhet përfshirë në buxhetin e vitit 2010.
- *Të hyrat potenciale nga privatizimi.* Misioni mirëpret përkushtimin e vazhdueshëm të qeverisë për privatizim të disa prej asetëve, përfshirë këtu PTK-në.

Ndërsa të hyrat nga shitja e PTK-së mund të jenë të mëdha, përfshirja e tyre në buxhet duhet të bëhet vetëm në bazë të një kalendari realist për transaksionin e mundshëm dhe pas vlerësimit të kujdesshëm të vlerës së kompanisë.

- Misioni mbështet përkushtimin e qeverisë për të marrë veprime të vendosura përmes politikave, për të forcuar projektbuxhetin 2010. Çështjet e ngritura më sipër sugjerojnë për dy mënyra të përmirësimit sa i përket formulimit të politikave. Pikësëpari, autoritetet duhet të kenë parasysh efektin e politikave afatshkurtra në qëndrueshmërinë fiskale. Së dyti, projektbuxheti duhet të jetë një paraqitje realiste e të hyrave dhe shpenzimeve që kanë gjasa të mira të materializohen.

*Politikat strukturore—Vitale për të mbështetur qëndrueshmërinë fiskale*

**5. Administrata tatimore dhe iniciativat tjera kanë një rol me rëndësi në mbështetjen e qëndrueshmërisë fiskale.** Misioni dëshiron të theksojë disa çështje strukturore me rëndësi që do të mund të forcojnë qëndrueshmërinë fiskale.

- *Administrata tatimore.* Përpjekjet për zgjerim të bazës tatimore duhen intensifikuar. Përmirësimet në mbledhjen e tatimeve vendore do të siguronin financim për zgjerimin e planifikuar mirë dhe të qëndrueshëm të shpenzimeve sociale dhe të shpenzimeve të tjera. Misioni i ardhshëm i asistencës teknike të FMN-së do tu ofrojë autoriteteve opsionet për rritje të mbledhjes së të hyrave.
- *Ligji për borxhin publik.* Misioni mirëpret progresin e vazhdueshëm sa i përket Projektligjit për borxhin publik. Rishikimet e fundit të projektligjit do të duhej të ndihmonin në kufizimin e detyrimeve potenciale për qeverinë qendrore, që shfaqen nga mos-pagesa potenciale nga huamarrësit komunal, përfshirë këtu kërkesën për një opinion të pakualifikuar të auditimit si parakusht për huazime nga komunat. Misioni rekomandon që nga komunat të kërkohej themelimi i bazës së shënimeve për menaxhim të shëndoshë financiar, të dëshmuar nga tri auditime të pakualifikuara të njëpasnjëshme. Për më tepër, komunave duhet tu ndalohej zotimi i granteve të qeverisë qendrore si peng për huazimet e tyre.

**6. Reforma gjithëpërfshirëse e sektorit të energjisë është jetike për konsolidimin fiskal të qëndrueshëm.** Misioni mirëpret marrëveshjen e arritur gjatë verës ndërmjet Qeverisë, USAID-it dhe Bankës Botërore për strategjinë e reformës për sektorin e energjisë. Misioni i shikon në mënyrë të favorshme hapat pasues të qeverisë dhe partnerëve të saj për vlerësim të kujdesshëm të implikimeve fiskale të reformave të miratuara. Veç kësaj, pasojat e vonësive potenciale në implementimin e këtyre reformave duhen vlerësuar me kujdes, marrë parasysh interesin me sa duket në rënie nga sektori privat për hyrje në sektorin energjetik të Kosovës.

*Stabiliteti i sektorit financiar—Nevojitet një koordinim i ngushtë i politikave*

**7. Nevojitet një koordinim i ngushtë i politikave për të ruajtur stabilitetin makroekonomik dhe të sektorit financiar.** Efekti i krizës financiare ndërkombëtare në

sektorin bankar të Kosovës deri më sot ka vazhduar të jetë i moderuar. Megjithatë, rreziqet nga ndezjet e krizës nuk janë larguar ende në tërësi, veçmas nëse merret parasysh prania e bankave të mëdha në pronësi të huaj. Koordinimi i ngushtë i politikave ndërmjet MEF-it dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) është jetik për të siguruar stabilitetin financiar dhe makroekonomik.

- *Financimi i buxhetit dhe dividendët e PTK-së.* Pagesa e pritur e dividendit të PTK-së është një burim i rëndësishëm i të hyrave të njehershme për qeverinë. Megjithatë, këto resurse janë një burim po aq i rëndësishëm—nëse jo më të rëndësishme—për financimin e sektorit të bankave komerciale. Misioni mirëpret vendimin e MEF-it për ti mbajtur këto fonde në bankat komerciale, që aktualisht ato i mbajnë si depozita. Megjithatë, është jetike që bankave tu jepet një periudhë adekuate kohore për të rimbushur bazën e tyre të financimit, për të kompensuar tërheqjen eventuale të këtyre depozitave nga qeveria. Misioni rekomandon përcaktimin e një kalendari kohor sa më të saktë për të ruajtur likuiditetin e sektorit bankar.
- *Bilancet në para të gatshme të qeverisë dhe funksioni i huazuesit të mjetit të fundit.* Euroizimi limiton masën e sigurimit të likuiditetit për sistemin bankar në masën e bilancit në para të gatshme që posedohen nga qeveria pranë BQK-së. Marrë parasysh rëndësinë bilancin e parasë së gatshme si burim primar i fondeve për një injeksion potencial të likuiditetit në sistemin bankar, objektivat e politikave fiskale duhet të zgjerohen dhe duhet të njohin përgjegjësinë e autoriteteve fiskale sa i përket stabilitetit financiar.
- *Ligji për bankën qendrore dhe koordinimi i politikave.* Me kuadrin ligjor ekzistues, BQK nuk ka autoritetin për të marrë përsipër operacionet e huadhënësit të mjetit të fundit. Për dallim, projektligji për bankën qendrore, i hartuar me asistencë nga FMN, siguron autoritet të limituar diskrecional për BQK-në në ushtrimin e këtij funksioni. Prandaj, misioni inkurajon miratimin e shpejtuar të këtij projektligji.

**8. Reputacioni i BQK-së është i lidhur ngushtë me suksesin e vazhdueshëm të saj në mbikëqyrje.** Përmirësimet e arritura në mbikëqyrjen e sektorit të sigurimeve duhet të mbajnë hapin me përmirësimet cilësore në mbikëqyrjen e sektorit bankar. Misioni mirëpret hapat më të fundit të ndërmarrë nga BQK për të ruajtur mbrojtjen e mbajtësve të polisave të sigurimit—mandati i saj kyç si rregullatore e sigurimeve – si dhe marrëveshjen e autoriteteve me Bankën Botërore për emërim të një këshilltari për çështjet e sigurimeve.

\*\*\*\*\*

*Dëshirojmë të falënderojmë bashkëbiseduesit tanë për mikpritjen e tyre dhe për diskutimet informuese.*

**Tabela 1. Kosova: Treguesit kryesor, 2007-12**

	2007	2008	2009	2010	2011	2012
		Vler.	Proj.	Proj.	Proj.	Proj.
<b>Shkallët e rritjes reale (në përqindje)</b>						
BPV	5.0	5.4	3.8	4.3	4.7	5.0
Të hyrat e disponueshme të sektorit privat	3.0	2.8	2.4	2.9	5.0	4.9
Konsumi i sektorit privat	8.1	3.2	1.9	3.7	4.0	4.4
BPV për kokë banori	3.8	3.8	2.3	2.8	3.2	3.4
Konsumi privat për kokë banori	6.8	1.7	0.4	2.1	2.5	2.8
<b>Ndryshimet e çmimeve (në përqindje)</b>						
IÇK, mesatarja për periudhën	4.4	9.4	-2.2	1.4	1.7	1.8
IÇK, fundi i periudhës	10.5	0.5	0.2	2.0	1.8	1.9
Deflatori i BPV-së	3.3	5.7	-1.9	1.8	2.1	2.3
<b>Buxheti i përgjithshëm i qeverisë (në përqindje të BPV)</b>						
Të hyrat	25.9	25.3	29.5	25.4	25.1	24.8
Shpenzimet	18.9	25.3	31.3	29.7	27.1	26.4
<i>Nga të cilat</i> : kapitali dhe huat neto	2.8	7.4	12.1	11.8	9.6	9.6
Bilanci primar	7.0	0.0	-1.8	-4.3	-2.0	-1.7
Bilanci i gjithmbarshëm	7.0	0.0	-2.0	-4.6	-2.3	-2.0
Stoku i bilanceve bankare të qeverisë (pa përfshirë escrow)	12.1	11.2	9.2	4.5	2.4	0.9
Stoku i bilanceve bankare të qeverisë (duke përfshirë escrow)	12.1	9.8	6.3	0.2	0.0	0.0
<b>Bilancet e kursimeve-investimeve (në përqindje të BPV)</b>						
Kursimet vendore	-12.2	-15.5	-15.6	-12.6	-8.8	-6.6
Transferet pa përfshirë qeverinë e përgjithshme (net) 3/	14.3	14.6	11.8	12.1	12.4	11.8
Faktori neto i të hyrave	5.3	4.0	4.2	5.1	5.0	5.3
Kursimet nacionale	7.4	3.2	0.3	4.6	8.6	10.6
Investimet	26.2	27.2	27.6	29.0	31.5	32.0
Llogaria rrjedhëse (pa grantet zyrtare)	-18.8	-24.1	-27.3	-24.4	-23.0	-21.4
<b>Bilanci i llogarisë rrjedhëse (me grantet zyrtare)</b>						
Asistenca e jashtme 4/	-10.2	-16.3	-18.4	-17.3	-18.1	-17.4
Investimet e huaja direkte neto	8.6	7.7	8.9	7.1	4.9	4.1
Investimi në portofol (net)	16.7	13.1	10.7	9.9	11.4	11.3
Investimet tjera	-1.1	0.5	-0.3	-0.6	-0.6	-0.6
Investimet tjera	-3.2	0.8	3.8	1.7	2.3	2.4
<i>Nga të cilat</i> : Ndryshimi në bilancet bankare të qeverisë (pa escrow)	-7.0	0.0	1.9	4.2	1.8	1.3
<b>Agregatet kryesore (në miliona euro)</b>						
BPV	3,464	3,724	3,792	4,028	4,306	4,625
BPV për kokë banori (në euro)	1,629	1,726	1,731	1,812	1,908	2,019
GNDI për kokë banori (në euro)	1,949	2,047	2,007	2,122	2,240	2,365
Transferet pa përfshirë qeverinë e përgjithshme (net) 3/	496	545	447	486	534	547
Popullata (në mijëra)	2,126	2,158	2,190	2,223	2,256	2,290

Burimet: autoritetet e Kosovës, vlerësimet e stafit të FMN-së.

1/ Parashikimi i stafit të FMN-së për vitin 2010, parashikimi për vitet pasuese në bazë të kornizës afatmesme të shpenzimeve të qeverisë.

2/ Bilanci ndërmjet kursimeve-investimeve për ekonominë si tërësi, duke përfshirë sektorin e donatorëve.

3/ Duke përfshirë pensionet nga vendet tjera dhe remitencat.

4/ Asistenca totale e jashtme pa përfshirë transferet kapitale